



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 150

Tiranë – E hënë, 17 gusht 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 29.7.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 331, datë 12.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit <i>On-line</i> (SQMO), që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara”..... 9505
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 649, 13.8.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale të njësisë të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Shijak dhe Kurbin..... 9505
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 13.8.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në bashkitë Tiranë dhe Kurbin..... 9506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 13.8.2020	Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare, si pasojë e COVID-19, për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas dhe ndërqytetas..... 9507
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 415, datë 11.8.2020	Për delegim kompetencash..... 9508



VENDIM

Nr. 648, datë 29.7.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 331, DATË 12.4.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT QENDROR TË MONITORIMIT *ON-LINE* (SQMO), QË DUHET TË PAGUAJNË SHOQËRITË E LICENCUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, e nenit 70, pika 12, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3, të kreut VI, të vendimit nr. 647, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe kriterëve të përzgjedhjes së operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit *on-line* (SQMO), si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 331, datë 12.4.2017, të Këshillit të Ministrave, emërtimi: “Kazino elektronike” zëvendësohet me fjalët: “Kazino/kazino të vendosura në hotele me 5 yje”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 649, datë 13.8.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË SHIJAK DHE KURBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 186 772 938 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Shijak dhe Kurbin.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi prej 90 172 938 (nëntëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale, për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara



rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi prej 96 600 000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak dhe Kurbin, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 650, datë 13.8.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E HARTIMIT TË
PROJEKTIT TË NDËRHYRJEVE
REHABILITUESE/PËRSHTATËSE, TË
NEVOJSHME PËR KTHIMIN E
STRUKTURËS SË OBJEKTEVE QË JANË
KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME
DËMTIME TË MËDHA STRUKTURE
OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA
JOSTRUKTURE, NË BASHKITË
TIRANË DHE KURBIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 144 289 030 (njëqind e dyzet e katër milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (me shkallë dëmtueshmërie DS4 dhe DS5), në bashkitë Tiranë dhe Kurbin.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 87 358 750 (tetëdhjetë e shtatë milionë e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (DS4 dhe DS5).

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi prej 56 930 280 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (DS4 dhe DS5).

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë dhe Kurbin, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 651, datë 13.8.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE,
TË DOKUMENTACIONIT DHE TË
MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
FINANCIARE, SI PASOJË E COVID-19,
PËR TË PUNËSUARIT APO ISH-TË
PUNËSUARIT NË SUBJEKTET E
TRANSPORTIT PUBLIK, QYTETAS DHE
NDËRQYTETAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Dhënie ndihme financiare prej 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekësh, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas dhe ndërqytetas.

2. E përfitojnë ndihmën, sipas pikës 1 të këtij kreu, punonjësit e deklaruar në listëpagesat e subjekteve si më sipër, pavarësisht nëse kanë përfituar ose jo nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare, të dhënë për këtë qëllim.

**II. KRITERET DHE
DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E
NDIHMËS FINANCIARE**

1. Ndihma financiare llogaritet dhe jepet për të punësuarit apo ish-të punësuarit, që figurojnë në listëpagesat e deklaruara për periudhën tatimore shkurt 2020, të cilat janë dorëzuar në muajin mars 2020.

2. Për punonjësit, të cilët kanë përfituar ndihmë financiare, sipas vendimit nr. 254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës së të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasoje e COVID-19”, ose të

vendimit nr. 305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasoje e COVID-19”, pagesa sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, do të kryhet automatikisht nga administrata tatimore, në bazë të të dhënave që kjo e fundit disponon.

3. Aplikimi për të përfituar ndihmën financiare për punonjësit apo ish-punonjësit, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë financiare, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 254, datë 27.3.2020, ose nr. 305, datë 16.4.2020, bëhet nga subjekti i të punësuarit. Në rastet e mosaplikimit nga ana e subjektit, ndihma financiare për të punësuarit do të jepet menjëherë pas miratimit nga administrata tatimore të aplikimit individual të tyre. Miratimi kryhet pas verifikimit të kriterëve, bazuar në të dhënat që administrata tatimore disponon apo të dhënat që të punësuarit do të dorëzojnë.

4. Subjektet/individët aplikues duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet portalit *e-Filing*, kërkesën me të dhënat e përfituesve, ku përfshihen:

- a) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS;
- b) të dhënat identifikuese të përfituesve, përfshirë:
 - i. emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën e *email-it*;
 - ii. numrin personal të identifikimit të përfituesit;
 - iii. bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;
 - iv. IBAN-in e llogarisë bankare.

**III. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR
PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE**

1. Administrata tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e aplikimit, verifikon në sistemin tatimor, identifikon aplikuesit dhe të dhënat në kërkesën e tyre, duke analizuar:

- a) tatimpaguesin dhe veprimtarinë e tij, për të verifikuar nëse bën pjesë në listën e veprimtarive që përfitojnë ndihmën financiare;
- b) krahasimisht listën e paraqitur për përfitim ndihme me listëpagesën e dorëzuar në mënyrë elektronike.



2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit listën përmbledhëse të individëve përfitues të ndihmës financiare, me të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën e *email*-it;

b) numrin personal të identifikimit të përfituesit;

c) bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit kryen pagesat për individët përfitues, sipas këtij vendimi.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ruan dhe administron dokumentacionin e përcaktuar, sipas këtij vendimi, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore, të parashikuara për ruajtjen e dokumentacionit dhe arkivat.

IV. MASA E NDIHMËS FINANCIARE

1. Ndihma financiare, që përfiton i punësuar aktual, përcaktohet në kreun I të këtij vendimi.

2. Ndihma financiare për të punësuarit, në shumën e përcaktuar, përfitohet vetëm një herë si shumë e vetme.

V. ÇËSHTJE TË FUNDIT

1. Efektet financiare, në masën 134 966 000 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, do të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR

Nr. 415, datë 11.8.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 12.8.2020 deri në datën 20.8.2020.

3. Për datat 13, 14 dhe 15 gusht 2020 delegohet edhe nënshkrimi i përgjigjeve për kërkesat social-juridike.

4. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

6. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë